

KALTRINA HOTI  
**VRAPO PAS DIELLIT**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



KALTRINA HOTI

VRAPO PAS DIELLIT

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recensent *dhe* redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Petrina Ago

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Në kopertinë: “Përcjell diellin” pikturë nga Kaltrina Hoti

ISBN 978-9928-277-37-4

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Me dashuri gjyshit tim Shar Ibër Haxhaj  
nga Hoti i Plavës*

GJYSHIT TIM

Në thellësi të tokës trupi pushon,  
Loti pikon mbi varrin e heroit,  
Atëherë kur frika vdes  
Guximi mbijeton.

## **VRAPO PAS DIELLIT**

Pa adresë nuk ke shtëpi,  
Unë e di adresën time,  
Atje ku miza bren hekur,  
Atje ku gjarpri ruan shtëpinë,  
Atje ku buka e uji kanë një emërues,  
Atje ku hija ruan varret,  
Atje ku vrapoj pas diellit,  
Është palca ime në rrënjë,  
Vrapo pas diellit,  
Shar Ibra i Hotit.

*DASHURIA,  
FJALË QË NUK THUHET*





## DASHURIA, FJALË QË NUK THUHET

Lojë të çuditshme  
Kjo natë bën me mua,  
Më shndërron në flakë  
Të yjeve të përgjumura,  
E mua gjumin nuk ma falë  
Për puthjen e dëshiruar,  
Që dua ta kthej në dritë  
Të agut.

Ikja e errësirës  
Më kujton kush jam,  
Shpirti i rrethuar me re të bardha  
Pëshpërit...  
Dashuria,  
Fjalë që nuk thuhet.

Ngadalë do të shtrihem  
Afër trupit të ngrohtë,  
Ëndrra të bëhet  
Këngë e gjumit për mua.

## ATË DITË

Më humbe,  
Kërkova dorën tënde,  
Vonë ishte,  
Diku nga largësia  
U dëgjua dënesja e fundit,  
U mësova të qaj pa lot.

## DO TA KUPTOSH

Një ditë do të zgjohesh  
Me dëshirë që koha të kthehet  
Ose të shpejtohet,  
Nuk i dihet,  
Një ditë do ta kuptosh,  
Aty ku kërkove dritë,  
Ishte terr,  
Aty ku kërkove dashuri,  
Kishte frikë,  
Aty ku ishe mbështetur,  
S'kishte themel,  
Një ditë do ta kuptosh,  
Të duhet vetja dhe askush tjetër,  
Mos u frikëso të jesh ti,  
Kur të qahet,  
Qaj,  
Derën e shtëpisë hape,  
Le të vijnë të gjitha stinët,  
Të luajnë me ty  
Akull, avull, ujë,  
Në fund të gjitha bëhen  
Pluhur.

## AROMË E KOHËS

Mendim i mjegullt,  
Hapësirë e bardhë,  
Unë depërtoj si ngjyrë e rrallë,  
Mbi kohën e premtuar  
Kërkoj fjalën e parë,  
Them... kaltërsi,  
Qiellin e fëmijërisë e pikturoj  
Me plagën e së shkuarës,  
Me shiun  
Fillon tingulli i kohës së humbur,  
Gurin e varrit e shndërroj  
Në portën e qytetit pa emër.

## **EDHE PAK**

Nëpër net pa ëndrra  
Simfonia e zogjve  
Ngushëllon,  
Në faqen time shkruaj mallin,  
Në frymë  
Kërkoj qetësinë,  
Hap dritaren  
Që era e malit të gjejë prehje  
Në mallin tim.

## NJË SHUPLAKË E PUTHUR

Duart e tua ngadalë  
I largoj nga gjiri im,  
Edhe pse nuk dua të ik'  
Nga përkledhja e mëngjesit,  
Dua të pikturoj  
Shpirtin tënd,  
Në mes mjegullës dhe rrezes  
Shpirti i gruas  
Pushon në shuplakë të puthur.

## BUZËQESHJA E PËRSËRITUR

Më tha:  
Ç'rëndësi ka  
Fjala e premtuar,  
Kur bota vërdallë  
Të thumbon me tradhtinë?  
Ç'rëndësi ka dashuria,  
Kur urrejtja rrjedh nga ajo?  
Ç'rëndësi ka qetësia,  
Kur është e shkurtër dhe e harruar?  
Ç'rëndësi ka paraja e paluar,  
Kur të shndërron në akull?  
Ç'rëndësi ka poezia,  
Kur me dinamikë të shpejtuar  
Asgjë më nuk rrjedh  
Në shtratin e vet?

Më tha:  
Mos ma prek gotën e rakisë,  
Aty ka mbetur guri i fjalës së gdhendur  
Dhe askush nuk mund ta marrë,  
Dje kërkova drejtësi,  
Sot m' i dhanë prangat,  
T' i lidh duart.

Më tha:  
Më duhet të rri i dehur,  
Vetëm atëherë dhembja ndalet.

I thashë:  
Mbushe edhe një për mua!

## **NATË E VERBËR**

E panjohur në lagjen e fëmijërisë,  
E panjohur në qytetin e rinisë,  
E mohuar në derën e nusërisë,  
Kryqëzohem mes shpresës  
Territ e dhembjes.



## MË THIRRNIM ME EMRIN TIM

Kur linda më quajtën rreze dielli  
E asgjë nuk shkëlqente tek unë,  
Më vonë më quajtën  
Dorë ledhatuese,  
E unë ledhatim nuk përjetova,  
Dikur, papritmas, dikush, tha:  
Emër i huaj,  
E unë kërkova oxhakun e vjetër,

Vendosa të pushtoj dallgët e trazuara,  
T'i bashkoj buzët  
Në mes diellit, qiellit dhe detit.

## **E LAKUAR**

Gozhdë e ndryshkur,  
E lakuar në dorën time,  
Në murin e bardhë e ngulita,  
Me ngjyrat e derdhura  
Murit i dhanë jetë.

## VJESHTA E PAHARRUAR

Atë ditë vjeshte  
Në frymë u shndërrova,  
Nuk më more,  
Nuk të mora,  
Pas na ndiqnin  
Gjethet e zverdhura.

## JO

Nuk më duhet  
Fjala e shtrydhur,  
Aty nuk ka fuqi, as shpresë,  
Nga hija ime jam larguar,  
Nuk e shkeli të kaluarën  
Me plagë të shëruara,  
Është një letër e vjetër  
Në murin tënd,  
Një ditë do ta lexojë kureshtja.